



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 334/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.06.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-11181-02-28-2019, me objekt: “*LOTI 2: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Tiranë, Durrës”*”, me fond limit të planifikuar për 2 vjet, në vlerë 43.593.744 lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 25.03.2019 nga autoriteti kontraktor Instituti i Shëndetit Publik.

Ankimues: “Fatos Lashi” p.f
Rruga Kavajës, Qendra Condor Center, Kati 4, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Instituti i Shëndetit Publik
Rr. “Aleksandër Moisiu” Nr. 80, Tiranë

Subjekte të Interesuar: “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k.
Rruga “Tre Vellezerit Kondi”, Nr. 6/1, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 28.02.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-11181-02-28-2019, me objekt: “LOTI 2: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Tiranë, Durrës”, me fond limit të planifikuar për 2 vjet, në vlerë 43.593.744 lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 25.03.2019 nga autoriteti kontraktor Instituti i Shëndetit Publik.

II.2. Në datën 25.03.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 02.04.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

Air	34.149 lekë, skualifikuar
Akademia e Shëndetit Publik	43.000 lekë, kualifikuar

Fatos Lashi
NRG

47.406 lekë, kualifikuar
50.410 lekë, kualifikuar

II.4. Në datën 08.04.2019 operatori ekonomik “Fatos Lashi” p.f ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht pretendohet si më poshtë:

- a. *Të bëhet skualifikimi i operatorit ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k, pasi në dijeninë tonë nuk ka as në pronësi as të marra me qira 4 makina me aparat mjegullues dhe pompë me presion të lartë përkatës, sepse me dy mjete ka marrë pjesë në tre lote duke bërë shkelje të rëndë të kriterëve të pëcaktuara nga AK. Vetëm Loti II kërkon dy makina me aparat mjegullues dhe pompë me presion të lartë.*
- b. *Të shpallet fitues si oferta me vlerë më të ulët, që plotëson të gjitha kriteret në zbatim të ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe DST-të.*
- c. *Shprehim bindjen e plotë që OE të kualifikuar kanë konflikt interesi me AK ISHP. Sipas informacioneve tona përfaqësuesit ligjorë të OE të kualifikuar, kanë konflikt interesi në mënyrë të tërthortë me procedurën e prokurimit me një nga punonjësit e ISHP, fakt i cili na bën të besojmë se kanë influencuar për një kualifikim të padrejtë të OE të caktuar ekonomik, duke abuzuar me detyrën si drejtues të Sindikatës së Punonjësve të Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të ligjit të sipërcituar.*

II.6. Me shkresën nr.76/33 prot datë 15.04.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.7. Në datën 24.04.2019 “Fatos Lashi” p.f ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar si më poshtë:

- a. *Të bëhet rivlerësimi dhe llogaritja e gabimeve aritmetike për të gjithë ofertat e dorëzuara sepse nëse do të llogaritet shumatorja e cmimeve për njësi me shërbimin e kërkuar të kryhet, vlera e ofertës tejkalon fondin limit.*
- d. *Të bëhet skualifikimi i operatorit ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k, pasi në dijeninë tonë nuk ka as në pronësi as të marra me qira 4 makina me aparat mjegullues dhe pompë me presion të lartë përkatës, sepse me dy mjete ka marrë pjesë në tre lote. Nëse ky operator shpallet fitues në të tre lotet a do të plotësohen kushtet e kërkuara në DST? Sipas kushteve të përcaktuara në DST dhe normalitetit të kryerjes së shërbimit, nuk ka mundësi që i njëjti mjet të përdoret në dy ose më shumë lote.*
- b. *OE “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k nuk plotëson kushtin e përcaktuar në DST në lidhje me kontratat e ngjashme. Nuk plotëson vlerën prej 40% të të gjitha loteve ku ka paraqitur ofertë.*
- c. *OE “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k nuk plotëson kushtin e përcaktuar në DST në lidhje me xhiron e realizuar mesatarisht gjatë tre viteve të fundit. Nuk plotëson vlerën prej 40% të fondit limit të loteve që ka ofertuar.”*

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.76/43 prot datë 06.05.2019, protokolluar me tonën me nr.750/2 prot datë 06.05.2019 me objekt “Dërgohet informacioni”, dhe shkresës nr. 76/42 prot., datë 06.05.2019, protokolluar me tonën 750/3 datë 06.05.2019, me objekt “Kthim përgjigje”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Fatos Lashi” p.f se: *“operatorit ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k, në dijeninë tonë nuk ka as në pronësi as të marra me qira 4 makina me aparat mjegullues dhe pompë me presion të lartë përkatës, sepse me dy mjete ka marrë pjesë në tre lote duke bërë shkelje të rëndë të kriterëve të pëcaktuara nga AK. Vetëm Loti II kërkon dy makina me aparat mjegullues dhe pompë me presion të lartë”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2, gërma “a” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është parashikuar plotësimi i kërkesës si vijon:*

“OE duhet të disponojë makineritë dhe paisjet e mëposhtme:

- a. *Aparat mjegullues për mjegull të ftohtë dhe Pompë me presion të lartë të montuar në një kamionçinë për lotet si më poshtë:*

Të paktën 2 (dy) Aparat mjegullues me pompë me presion, të montuar në një kamionçinë për Lotin 2.

Për këto pajisje OE ofertues duhet të paraqesë dokumentat si më poshtë:

- i. *Në rastin e pronësisë, OE duhet të paraqesë lejen e qarkullimit të kamionçinës, (në të cilën është montuar aparati mjegullues dhe pompa me presion të lartë) kolaudimin dhe TPL-në, përgjatë kohës së ekzekutimit të shërbimit, si dhe të paraqiten gjithashtu certifikata e pronësisë, fotot e makinës me aparatet e montuara, ku të jetë e dukshme lloji i aparateve, targa e kamionçinës dhe numri i identifikimit të motorrit të sistemit. Pesha mbajtëse e kamionçinës të jetë jo më pak se 1 (një) ton, logo e dukshme e kompanisë, fenolina/ngjyra portokalli.*
- ii. *Në rastin kur mjetet janë në përdorim, OE duhet të paraqesë kontratën e qirasë me kohëzgjatje përgjatë periudhës së ekzekutimit të shërbimit, të shoqëruar me lejen e qarkullimit të kamionçinës, ku të jetë montuar aparati mjegullues dhe pompa me presion të lartë, si edhe faturën e blerjes/deklaratën doganore të aparatit mjegullues dhe pompës me presion të lartë, si dhe një deklaratë se do të përdorë ekzaktësisht të njëjtën lloj kamionçine, aparat mjegullues dhe pompë (me të cilën ka ofertuar), përgjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të shërbimit. Të paraqiten gjithashtu edhe fotot e makinës me aparatet e montuara, ku të jetë e dukshme lloji i aparateve, targa e kamionçinës dhe numri i identifikimit të motorrit të sistemit.”*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik *“Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k* në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion për dy automjete si më poshtë vijon:

Për mjetin me targë AA 365SD:

- Kontratë Qeraje Nr.131 prot., datë 21.03.2019 lidhur ndërmjet shoqërisë *“Gjoka Konstruksion” sh.p.k*, në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë *“Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k* në cilësinë e qeramarrësit për dhënien me qira të automjetit me targë AA365SD, për tenderin me objekt: *“LOTI 2: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Tiranë, Durrës”*, me fond limit të planifikuar për 2 vjet, në vlerë 43.593.744 lekë pa TVSh.
- Leje qarkullimi në emër të shoqërisë *“Gjoka Konstruksion” sh.p.k*.
- Çertifikatë e kontrollit teknik të mjetit me targë AA365SD, ku përcaktohet tipi i mjetit *“Kamioncinë”* dhe raporti i kontrollit teknik.
- Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit me periudhë nga 06.08.2018 – 05.08.2019
- Foto të mjetit me aparatura të montuara.

Për mjetin me targë AA746NE

- Leje qarkullimi në emër të shoqërisë *“Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k*
- Foto të mjetit me aparatura të montuara.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

III.1.4. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.5. Në VKM nr.914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, neni 28 *“Kontratat e Shërbimeve”*, pika 5, përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

c) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.1.9. Përsa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, operatori ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” ka dorëzuar dokumentacion për dy kamioncina, njërën në pronësi të shoqërisë ofertuese “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k dhe tjetrën të marrë me qira nga shoqëria “Gjoka Konstruksion” sh.p.k, specifikisht për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Për mjetin me targë AA 365SD, të marrë me qira, referuar dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike nga ana e operatorit ekonomik “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k rezulton se është paraqitur Kontratë Qeraje Nr.131 prot., datë 21.03.2019 lidhur ndërmjet Shoqërisë “Gjoka Konstruksion” sh.p.k, në cilësinë e qeradhënësit dhe shoqërisë “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k në cilësinë e qeramarrësit për dhënien me qira të automjetit me targë AA365SD, për tenderin me objekt: “*LOTI 2: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Tiranë, Durrës”*”, shoqëruar me leje qarkullimi në emër të “Gjoka Konstruksion” sh.p.k, Çertifikatë e kontrollit teknik të mjetit kamioncinë dhe raporti i kontrollit teknik, policë për sigurimin e detyrueshëm të mjetit për periudhën nga 06.08.2018 – 05.08.2019 dhe foto të mjetit me aparatura të montuara. Në dokumentat e tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar shprehimisht se: *kur mjetet janë në përdorim, OE duhet të paraqesë kontratën e qirasë me kohëzgjatje përgjatë periudhës së ekzekutimit të shërbimit, të shoqëruar me lejen e qarkullimit të kamionçinës, ku të jetë montuar aparati mjegullues dhe pompa me presion të lartë, si edhe faturën e blerjes/deklaratën doganore të aparatit mjegullues dhe pompës me presion të lartë, si dhe një deklaratë se do të përdorë ekzaktësisht të njëjtën lloj kamionçine, aparat mjegullues dhe pompë (me të cilën ka ofertuar), përgjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të shërbimit. Të paraqiten gjithashtu edhe fotot e makinës me aparatet e montuara, ku të jetë e dukshme lloji i aparateve, targa e kamionçinës dhe numri i identifikimit të motorrit të sistemit.*”

Në rastin konkret në ofertën e shoqërisë mungon deklarata e ofertuesit se mjeti kamioncinë me targë AA 365SD me aparat mjegullues dhe pompë do të përdorë ekzaktësisht përgjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të shërbimit.

Për mjetin me targë AA 746NE emër të shoqërisë “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k, është paraqitur leje qarkullimit dhe foto të mjetit me aparatura të montuara, por në ofertë mungon dokumentacioni që vërteton kolaudimin dhe TPL-në e mjetit si dhe certifikata e pronësisë, në kundërshtim me kërkesën e autoritetit kontraktor që: *“Në rastin e pronësisë, OE duhet të paraqesë lejen e qarkullimit të kamioncinës, (në të cilën është montuar aparati mjegullues dhe pompa me presion të lartë) kolaudimin dhe TPL-në, përgjatë kohës së ekzekutimit të shërbimit, si dhe të paraqiten gjithashtu certifikata e pronësisë, fotot e makinës me aparatet e montuara, ku të jetë e dukshme lloji i aparateve, targa e kamioncinës dhe numri i identifikimit të motorrit të sistemit. Pesha mbajtëse e kamioncinës të jetë jo më pak se 1 (një) ton, logo e dukshme e kompanisë, fenolina/ngjyra portokalli.”*

Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: *“Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”*; *“Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”*, KPP gjykon se shoqërisë “Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k nuk ka paraqitur dokumentacion në përputhje me kriteret kualifikuese dhe nenin 46 të LPP-së si më sipër cituar.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që nga dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik të vërtetohet se gëzon dhe disponon kapacitetet e duhura në lidhje me mjetet për realizimin me sukses të kontratës, fakt ky që duhet vërtetuar nëpërmjet dokumentacionit përkatës, në përputhje me kriteret kualifikuese.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Fatos Lashi” p.f, të parashtruara pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se ankimuesi nuk ka ezuaruar ankim administrativ pranë autoritetit kontraktor në respekt të nenit 63 pika 2 të *lex specialis* si një shkallë e parë e ankimit administrative, ku parashikohet shprehimisht se *“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji”*, ndaj dhe këto pretendime nuk merren në shqyrtim nga ky Komision.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Fatos Lashi” p.f për procedurën e prokurimit me Nr.REF-11181-02-28-2019, me objekt: *“LOTI 2: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Prefekturat Tiranë, Durrës”*, me fond limit të planifikuar për 2 vjet, në vlerë 43.593.744 lekë pa TVSh, zhvilluar në datën 25.03.2019 nga autoriteti kontraktor Instituti i Shëndetit Publik.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik *“Akademia e Shëndetit Publik” sh.p.k*, duke e s’kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Fatos Lashi” p.f .
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 750 Protokolli,

Datë 24.04.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha